




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH
MUNICIPAL OF ASSEMBLY IN DRAGASH
SKUPSTINA OPSTINE DRAGAS



NJOFTIM

Komuna e Dragashit është në proces të organizmit të dëgjimeve buxhetore me qytetarë për Buxhetin e vitit 2026. Me qëllim të sigurimit të gjithëpërfshirjes, me theks në pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme qytetare, Komuna e Dragashit ka përpiluar dhe publikuar Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore për Buxhetin e vitit 2026. Për këtë qëllim, ekzekutivi i Komunës gjatë muajit gusht ka paraparë të organizohen dy (2) dëgjime buxhetore me qytetarë dhe grupe të ndryshme të interesit, si dhe gjatë muajit shtator një dëgjim buxhetor i organizuar nga Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF).

Andaj, me qëllim të angazhimit aktiv dhe planifikimit të buxhetit të Komunës bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, Komuna e Dragashit ju fton në:

Dëgjimin buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar (gra, vajza, përfaqësues të komunitetit joshumicë, pensionistë, persona me nevoja të veçanta etj.)

KOHA: E hënë, 11 Gusht 2025, Ora 11:00

VENDI: Salla e Asamblesë Komunale në Dragash

Kalendarin e organizmit të dëgjimeve buxhetore mund ta gjeni në këtë link: <https://dragash.gov.rs/kalendar-i-organizmit-ta-degjimeve-buxhetore>

Informacionet për projekt-buxhetin dhe dokumentet tjera buxhetore mund t'i gjeni në këto linqe:

<https://dragash.gov.rs/kab-2025-2027>

<https://dragash.gov.rs/financa>

Nëse nuk keni mundësi për të marrë pjesë me prezencë fizike në këtë takim, kërkesat, komentet dhe sugjerimet për Kornizën Afatmesme Buxhetor (KAB) 2025-2027 mund t'i dërgoni në këto email adresa: qytetar@dragash.gov.rs, mirim@dragash.gov.rs dhe proj.kolloni@dragash.gov.rs

Me respekt,

Zyra për Informim – Komuna e Dragashit

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash

02 Nr. Pr. 400/01-15 248/25
29.07.2025
Dragash - Dragash